REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.1021/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si kontestimore, në përbërje me Gjyqtarin individual Vesna Milic, në çështjen juridike të paditësit: F.I nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. V.M me seli në Mitrovicë, kundër të padituës: K... me përfaqësuesin A.M, për shkak të kompensimit të të ardhurave në emër të shpërblimit jubilar, pas mbajtjes së seancës kryesore publike me dt. 19.03.2021, në pranin e palëve ndërgjyqëse mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit: F.I nga Mitrovica dhe,

II. OBLIGOHET e paditura K... , paditësit F.I nga Mitrovica t'ia paguajë në emër të pagesës për shpërblim jubilar, për më shumë se 20 vite të përvojës së punës, shumën prej 1,012.10€ (njëmijë e dymbëdhjet euro e dhjetë cent), të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri ne pagesën definitive te detyrimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. OBLIGOHET e paditura K... , t'ia paguajnë paditësve shpenzimet e procedurës në shumë te përgjithshme prej 269.00€, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes te autorizuarit me dt. 02.10.2020 ka ushtruar padi pranë kësaj gjykate, duke kërkuar kompenzimin në shpërblim jubilar për paditësin, drejtuar të të padituës, në emër të shpërblimit jubilar, për përvojën e punës për më shumë se 20 vite, konform nenit 17 par.3 nën par.3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësis e dt. 11.06.2018.

Gjykata, me dt. 19.03.2020, ka caktuar seancë për shqyrtim kryesor, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësve, dhe përfaqësuesi i të padituës.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroj se: mbes në tërsi pranë padisë dhë kërkesapadisë, duke

i propozuar gjykatës që në bazë të kontratës kolektive sektoriale, në emër të shpërblimit jubilar, për më shumë se 20 vite të përvojës së punës t'ia paguaj shumën prej 1,012.10€. Po ashtu deklaron se hjek dorë nga kamata ligjore. Shpenzimet e procedurës i kërkon dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro, për përfaqësim në seancë shumën prej 135.00 euro, për pagimin e taksës për padi shumën prej 30.00 euro.

Përfaqësuesi i të padituës në seancën shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: e konteston padinë dhë kërkespadinë për shkak se Komuna në buxhetin e vet nuk ka mjete financiare. I njëjti deklaron se nuk është kontestuese se paditësi ka më shumë se 20 vite përvojë pune të e paditura, e të cilat vazhdon që të punoj tek e njëjta. Po ashtu nuk e konteston as lartësia e pagës mujore, bazuar në pasqyren financiare e cila gjendet në shkresat e lëndes dhe dokumenatacionin tjetër përcjellës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, referuar nenit 7 dhe 8 te LPK-së, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik nxori dhe administroi këto prova: Vërtetimi mbi përvojën e punës me Nr.671 e dt. 19.08.2020, Kërkesa drejtuar të paditures për kompensimin e pagave jubilare Nr.760 e dt. 08.09.2020, Kontrata e Punes e lidhur ne mës të paditësit dhe të paditures Nr.263 e dt. 01.09.2017, Lista e pages dhe pas shqyrtimit bashkërisht të të gjithave gjykata konstatoi këtë gjendje:

Fillimisht paditësi i është drejtuar të paditures me kërkesën për kompensmin e pagave jubilare, ky fakt vërtetohet nga kërkesa Nr.760 e dt. 08.09.2020, në bazë të shkresave të cilat gjenden në lëndë u vërtetua se ndaj kërkesës së ushtruar nga i autorizuari i paditësit, e paditura nuk i është përgjigjur.

Nuk është kontestues fakti se paditësi është marrëdhënie pune te e paditura për më shumë se 20 vite, ku ky fakt vërtetohet bazuar në Kontratën e punës Nr.263 e dt. 01.09.2017 e lidhur në mes të paditësit dhe të padituës, si dhe nga vërtetimi Nr.671 e dt. 19.08.2020, lëshuar nga e paditura, me të cilin vërtetohet se paditësia është në marrdhënie pune te e pditura që nga dt. 01.09.1999 e tutje.

Lartësia e pagës së paditëses, që e ka realizuar te e paditura si rezultat i punës së kryer është në shumë prej 506.05€, e në rastin konkret për 20 vite të përvojës së punës, e në emër të dy pagave jubilare, paditësi gëzon të drejtën e kompensimit në shumë prej 1,012.10€, ku ky fakt vërtetohet nga lista e pagave lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Po ashtu gjykata deklarimet e përfaqësuesit të të padituri në seancën e shqyrtimit kryesor i mori parasysh, por të njëjtat pretendime gjykata i refuzoi si të pa bazuara për faktin se bazuar në ligjet në fuqi është një e drejtë e pa mohueshme e cila i takon paditësit në realizimin e të drejtës në page jubilare sipas përvojës së punës, andaj gjykata duke u bazuar ne Kontratën Kolektive Sektoriale të miratuar me dt. 11.06.2018, vendosi si në pikën II të dispozitivit, sa i përket pagesave në emër të dy pagave për shpërblim jubilar, ashtu që duke iu referua nenit 17 par.3 nën par.3.2, të kontratës së lartcekur me të cilën parashihet se **"Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij",** andaj paditësi në këtë rast ka më shumë se 20 vite përvojë pune tek e paditura.

Bazuar në nenin 17 par.4 Kontratën Kolektive Sektoriale është detyrim i punëdhënësit te fundit këtu të padituës që ti paguaj kompensimin për kategorinë e lartcekur.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara, i referohet shpenzimeve dhe atë për përpilimin e padis shumën prej 104.00 euro, për përfaqësim në një seanc shumën prej 135.60 euro dhe në emër të taksës për padi shumën prej 30.00 euro.

Gjykata aktgjykimin e saj e bazoi ne nenin 143 par 1 te LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.1021/2020 dt. 19.03.2021

G J Y Q T A R I
Vesna Milic d.v.

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet përmes kësaj Gjykate.

Vërtetoi saktësin e kopjes